



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3150/1 prot.

Pogradec, më 15.08, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. LAVDIMIR BIBA, FSHATI BUZAISHT,
Ni.A. VELÇAN, BASHKIA POGRADEC, PËR HUMBJEN E JETËS SI PASOJE E RËNIES SË
RRUFESË

Me respekt,

K R Y E T A R I

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___, datë ___.2025

PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.LAVDIMIR BIBA, FSHATI BUZAISHT,
Nj.A. VELÇAN, BASHKIA POGRADEC, PËR HUMBJEN E JETËS SI PASOJE E RËNIES SË
RRUFESË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z. Lavdimir Biba, për shkak të humbjes së jetës nga rënia e rrufesë në datën 04.08.2025
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit L. Biba ndihmën emergjente në vlerën prej **500,000 Lek** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

K R Y E T A R E
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE , STREHIMIT DHE
ADMINISTRIMI I TOKËS BUJQËSORE NË NJ. A., SHERBIMEVE DHE TITUJVE TE PRONESISE

Nr. 3150/prot.

Pogradec, më 15.08. 2025

RELACION

PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. LAVDIMIR BIBA, FSHATI BUZAISHT, NJ. A. VELÇAN, BASHKIA POGRADEÇ, PËR HUMBJEN E JETËS SI PASOJE E RËNIES SË RRUFESË

Të nderuar këshilltarë!

Në fshatin Buzaisht, Njesisë Administrative Velçan, si pasojë e rënies së shirave dhe të shkarkesave elektrike të datës 04.08.2025 humbi jetën z. Lavdimir Biba tek kulloste bagetitë.. Nga rënia e rrufesë u dëmtuan edhe 22 krerë (10 të Leshta dhe 12 të dhirta), të cilat ishin gruposur sipas procedurës në prani të specialistit veteriner, zyrtar të shërbimit, përfaqësues të Njesisë Administrative Velçan, Kryeplakut të fshatit Velçan dhe komisionit veteriner. Në vendin ku ndodhi fatkeqësia natyrore, kafshet e ngordhura u gruposën dhe u dizinfektua vendi.

Mbështetur në ligjin Nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" si dhe V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", në paragrafin e III-të, në piken 1, të vendimit të mësipërm tregohet procedura e vlerësimit të dëmit si më poshte:

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njesisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën "ç" të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara.



Ne VKM 329, datë 16.05.2012, pika ç thote:

ç)Masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme akordon në rastin e humbjes së jetës së antarve të familjes si pasojë e fatkeqësisë është 500000(pesëqind mijë)lekë për çdo person të vdekur.

Duke qene se VKM 329 eshte vjeter ne baze te ligjit nr Ligji 45/2019 date 18.07.2019"Per Mbrojtjen Civile" Autoriteti Pergjegjes per demshperbilm eshte Bashkinae Pogradec .

Këshilli i Bashkisë pasi shqyrton procesverbalet për konstatimin e gjëndjes apo ato të komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut, si edhe gjithë dokumentacionin shoqërues që vërteton vërtetësinë e ngjarjes, merr vendimin për dhënien ndihmës financiare. Këtij vendimi i bashkëngjitet edhe dokumentacioni i mëposhtem:

1. Kërkesa nga Z.Dalip Biba për ndihmë për humbjen e jetës të z. Lavdimir Biba dhe vlerësimin e dëmit;
2. Urdhri i Kryetarit për ngritjen e komisionit te konstatimit dhe vlerësimit;
3. Procesverbali i konstatimit të gjëndjes;
4. Skeda e Vdekjes per humbjen e jetës të z. Lavdimir Biba
5. Çertifikatë familjare e Z. Lavdimir Biba
6. Fotografi

Për këtë arsye, pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, propozohet t'i akordohet ndihma financiare në një shumë prej 500.000 (pesëqindmijë) lekë.

Duke patur besimin në mbështetjen tuaj ju ftojme të votoni këtë projekt-vendim.

**DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE,
STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TE TOKES
BUJQESORE NJ. A.SHERBIMET DHE TITUJT E
PRONESISE**

Konceptoi: Anesti Ibi

Pranoi: Majlinda Ziko

Miratoi: Besmira Niko

Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**